



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 21 .08. 2025

VENDIM

Nr. 22 Datë 21 /08 /2025

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHES

1. Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 17.56, 57 dhe Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Pogradec në mbledhjen e datës 28.08.2025

1.1 Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.

1.2 Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.

1.3 Projekt – Vendim : Miratimi i Procesverbalit të datës 28.07.2025.

1.4 Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.07.2025.

1.5 Projekt – Vendim : Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Korrik 2025.

1.6 Projekt – Vendim : Miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambiente arsimore në Bashkinë Pogradec për vitin shkollor 2025-2026.

1.7 Projekt – Vendim : Për akordimin e ndihmës financiare z.Lavdimir Biba, fshati Buzaisht, Nj.A Velcan, Bashkia Pogradec, për humbjen e jetës si pasojë e rënies së rrufesë.

1.8Projekt – Vendim : Miratimin e projekt marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt I kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.

1.9 Projekt – Vendim : Për miratimin e planit vendor të veprimit për Barazinë Gjimore 2025-2030, të Bashkisë Pogradec.

1.10 Projekt – Vendim: Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ndërtim fotovoltaikë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m² (treqind e tremijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntëmijë) m².

1.11 Projekt – Vendim: Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.

1.12 Raportim nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në lidhje me hapësirat publike.

1.13 Raportim nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike në lidhje me masat e marra dhe punën e kryer për fillimin e vitit të ri arsimor 2025-2026 në arsimin parauniversitar.

1.14 Të tjera.

2. Ngarkohet Sekretarja e Këshillit, në mungesë Kryetarja e Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes në mediat sociale, lokale dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës për çdo këshilltar, te kryetari i Bashkisë Pogradec, Deputetët e Bashkisë Pogradec dhe personat apo dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te kryetari i Bashkisë Pogradec.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

ZV/ KRYETARE

Miranda OLLDASHI

